

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01Nr.61/2019	Data: 31.05.2019	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, nr.28/2008), nenit 15 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe në pajtim me nenin 33. Paragrafi 33.1. pika 11) të Statutit të Komunës 01 Numër 62/10, në mbledhjen e mbajtur më: 31.05.2019 mori këtë:

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT
PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

1. Më këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi 01Nr.15/2018, i datës 29.03.2018 për themelimin e KKSBB dhe atë si në vijim :
 - 1.1 Në vend të Xhafer Blakaj, caktohet Zenun Bujupaj, Përfaqësues i Komunitetit shqiptar dhe
 - 1.2 Në vend të Luljeta Shabaj, caktohet Enver Boletini, Përfaqësues i KLSP-së.
2. Anëtarët e KKSBB-së detyrat, përgjegjësitë dhe funksionin do t'i kryejnë bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.
3. Anëtarët e KKSBB-së kanë mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit të Komunës.
4. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit 01Nr.15/2018, të datës: 29.03.2018.
5. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyren e protokollit të MAPL-së si dhe pas publikimit të tij në ueb faqen zyrtare të Komunës së Istogut.
6. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, anëtarët e KKSBB-së dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.


 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE
 Uales-izlazna
 Nr. 039-26 Data 07-06-2019.
 Br. Datum


 KRYESUESI I KUVENDIT,
 z. Qaush BALAJ

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.62/2019	Data: 31.05.2019	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe neni 40 paragrafi 40.2 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe në pajtim me nenin 33. Paragrafi 33.1. pika 5) të Statutit të Komunës 01 Numër 62/10 dhe nenit 5 të Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores 2/2017 për ndarjen e bursave për studentë, në mbledhjen e mbajtur më: 31.05.2019 mori këtë:

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË

1. Formohet Komisioni për ndarjen e bursave për studentë, në këtë komision caktohen këta anëtar:

1. Hajrush Shoshi, Drejtori i Drejtoratit për Arsim dhe Kulturë, Kryesues;
 2. Valbona Demaj, nga radhët e LDK-së anëtare,
 3. Nexhmedin Balaj, nga radhët e AAK-së anëtar,
 4. Labinot Aliaj, nga radhët e PDK-së anëtar,
 5. Mirjeta Beqiraj, nga shoqëria civile anëtare.
2. Komisioni i cekur më lartë, do të bëjë përzgjedhjen e studentëve për ndarjen e bursave; ky komision vlerësues do të kryej të gjitha punët e caktuara me rregullore dhe ligj.
3. Obligohet Drejtoria për Arsim që t'i kryej të gjitha punët administrativo – teknike të domosdoshme për komision.
4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyren e Protokollit të MAPL-së si dhe pas publikimit të tij në ueb faqen zyrtare të Komunës së Istogut.
5. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: MAPL-ja, Kryetari i Komunës, anëtarët e komisionit dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.



 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Uales-Izlazna

Nr. 01-039-27 Data 02-06-2019


 KRYESUESI I KUVENDIT,
 z. Qaush BALAJ

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.63/2019	Data: 31.05.2019	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe neni 40 paragrafi 40.2 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, nr.28/2008) dhe në pajtim me nenin 33. Paragrafi 33.1. pika 5) të Statutit të Komunës 01 Numër 62/10 dhe nenit 10 të Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores 2/2017 për ndarjen e bursave për studentë, në mbledhjen e mbajtur më: 31.05.2019 mori këtë:

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE PËR NDARJE TË BURSIVE

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave ndaj komisionit vlerësues të ndarjes së bursave, në komision emërohen:

1. Riza Dreshaj, nga radhët e LDK-së kryesues,
2. Jehona Haxhijaj, nga radhët e AAK-së, anëtare,
3. Edona Bujupi-Loxha, nga ekzekutivi, anëtare,
4. Fazli Stollaj, nga ekzekutivi anëtar,
5. Fabian Ferizaj, nga shoqëria civile anëtar.

2. Komisioni i cekur më lartë, do të bëjë shqyrtimin e të gjitha ankesave ndaj komisionit vlerësues dhe do të kryej të gjitha punët e caktuara me rregullore dhe ligj.

3. Obligohet Drejtoria për Arsim që t'i kryej të gjitha punët administrativo - teknike të domosdoshme për komision.

4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyren e protokollit të MAPL-së si dhe pas publikimit të tij në ueb faqen zyrtare të Komunës së Istogut.

5. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: MAPL-ja, Kryetari i Komunës, anëtarët e komisionit, shërbimi për punë të kuvendit dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.


 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Uales-Izlazna

Nr.

01-039-28

Data

07.06.2019

Br.



KRYESUESI I KUVENDIT,
Z. Qaush BALAJ